



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr _____ prot

Tiranë më ____ . ____ . 2024

VENDIM

Nr. 267, datë 24.05.2024

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL, TË
GJYQTARIT TË KOMANDUAR NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
ZNJ. {...}, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 02.03.2020- 14.06.2023**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronjat a) dhe ë) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 68 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 61, pika 1, nenin 63 dhe nenin 86, shkronja dh), të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 159, datë 05.04.2023 “Rregullat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të komanduar në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.70 datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, pas verifikimit të plotësimit nga gjyqtarja znj. {...} të kriterëve të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për pozicionet e shpallur me vendimet nr. 239, nr. 244, nr. 247 datë 24.05.2023, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe pas shortit të realizuar,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës së vlerësimit etik dhe profesional për periudhën e vlerësimit 02.03.2020 - 14.06.2023, për gjyqtaren znj. {...}, gjatë ushtrimit të detyrës si nëpunës përgjegjës për vlerësimin në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, si dhe ka plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
2. Caktimin e znj. Emona Muçi si relatore për vlerësimin e gjyqtares së komanduar, znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

dhe Veprimtarisë Profesionale: Emona Muçi